



**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**MINISTRIA E FINANCAVE**

**U D H E Z I M**

**Nr. 50, Date 9.12.2009**

**“MBI KRIJIMIN DHE PERDORIMIN E FONDIT TE VECANTE NGA NJESITE E QEVERISJES SE PERGJITHSHME”**

Ne zbatim te vendimit te Keshillit te Ministrave nr.1151, date 25.11.2009 “Per krijimin dhe perdorimin e fondit te vecante”, pika 8, Ministri i Financave,

**U d h e z o n:**

1. Fondi i vecante ne njesite e qeverisjes se pergjithshme do te krijohet ne masen 5% te fondit te planifikuar te pagave. Fondi i planifikuar i pagave, per efekt te llogaritjes se fondit te vecante, do te perfshije vetem fondin e pagave te planifikuar per numrin e miratuar te punonjesve buxhetore. Ne kete fond nuk perfshihen fondi i pagave qe perdoret per punonjesit me kontrate, per punonjesit ne liste pritje, per ushtaraket ne reforme, punonjesit arsimore ne dispozicion, pagesa e bashkeshorteve te ushtarakeve, studenteve ushtarake, punonjesve me kontrate te perkohshme, etj.
2. Ky fond i planifikuar te perdoret nga drejtuesit e njesive te qeverisjes se pergjithshme per:
  - Shperblimin e punonjesve per rezultate te mira ne pune;
  - Shperblimin e punonjesve ne fund te vitit kalendarik;
  - Shperblime te tjera te parashikuara me akte te tjera ligjore apo nenligjore;
  - Dhenie ndihmash te menjehershme per raste fatkeqesish dhe raste te tjera;
  - Veprimtari social-kulturore.
3. Shperblimi per rezultate te mira ne pune gjate vitit, per cdo punonjes, do te jete i diferencuar por jo me shume se 1 (nje) page mujore per person ne vit. Ky shperblim, ne njesite e qeverisjes se pergjithshme, te cilat jane ne fushen e veprimit te ligjit te sherbimit civil, jepet i diferencuar ne baze te rezultateve individuale ne pune, sipas parimeve dhe procedures se percaktuar ne legjislacionin e sherbimit civil dhe ne perputhje me fondin e shperblimit ne dispozicion. Gjithashtu, ne njesite e qeverisjes se pergjithshme, te cilat nuk perfshihen ne fushen e veprimit te ligjit te sherbimit civil, shperblimi i punonjesve do te behet i diferencuar ne baze te performances se punonjesit, por jo me shume se 1(nje) page mujore per person.
4. Perjashtimisht per Drejtorine e Pergjithshme te Tatimeve masa e shperblimit mund te jete deri ne 2 (dy) paga mujore ne vit. Por shperblimi mbi nje page mujore ne vit do te kushtezohet vetem per punonjesit te cilet kontribuojne drejtpersedrejti ne rritjen e te ardhurave tatimore pas miratimit te nje udhezimi specifik mbi kriteret e rregullat e perfitimit te shperblimit, udhezim i cili miratohet nga Ministri i Financave.

5. Edhe ne rastet kur sipas ligjeve te vecanta lindin te drejta specifike te shperblimit te punonjesve, ky shperblim perballohet nga fondi i vecante. Ky rregull nuk zbatohet vetem kur ne ligjin perkates jane parashikuar burime te tjera specifike te ndryshme nga fondi i vecante. Ne keto raste specifike shperblimi jepet pas miratimit nga titullari perkates te nje udhezimi ne te cilin parashikohen rregullat dhe kriteret e perfitimit te shperblimeve mbi nje page mujore.
6. Shperblimi ne fund te vitit i jepet cdo punonjesi buxhetor per festat e fundvitit, ne masen 10 000 (dhjete mije) leke dhe perballohet nga fondi i vecante.
7. Ne ndihma te menjehershme per raste fatkeqesish dhe raste te tjera te cilat perballohen nga fondi i vecante perfshihen pagesat per:
  - Rastet e vdekjes se punonjesit ose te nje anetari te familjes se punonjesit (prinderit apo femijet) kur bashkejetojne. Pagesa jepet nga titullari i institucionit i diferencuar nga 10 000-30 000 leke per cdo rast.
  - Rastet e semundjeve te renda te punonjesit kur kerkohet nje nderhyrje shendetesore jashte vendit. Pagesa jepet nga titullari i institucionit, i diferencuar nga 30 000-50 000 leke per cdo rast.
  - Rastet e daljes se punonjesve ne pension pleqerie. Pagesa jepet nga titullari i institucionit ne masen e nje page mujore.
8. Veprimtarite e ndryshme qe kane karakter social apo kulturor sikurse jane ato te organizuara per rastet e daljeve ne pension, te festimeve te fundvitit, dhe te tjera organizime te realizuara nga institucioni, mund te perballohen nga fondi i vecante.  
Ne keto veprimtari social-kulturore, kur ato organizohen jashte qendres se punes, shpenzimet e transportit dhe akomodimit paguhen nga vete punonjesit.
9. Fondi i vecante i planifikuar sipas pikes 1 te ketij udhezimi, ne momentin e perdorimit te tij sipas pikes 2, do te perllogaritet per t'u shpenzuar duke u bazuar ne numrin faktik te punonjesve ne njesite e qeverisjes se pergjithshme.

Ky udhezim hyn ne fuqi menjehere.

**Ridvan BODE**

---

**MINISTER**



**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**MINISTRIA E FINANCAVE**  
**DREJTORIA E PERGJITHSHME E BUXHETIT**

Nr.     prot.

Tirane, me .....2009

---

**Per:**       **Ministria/institucioni** \_\_\_\_\_

**Per dijeni:** **Drejtorise se Pergjithshme te Thesarit**

**Subjekti:** Percillet Udhezimi “Mbi krijimin dhe perdorimin e fondit te vecante nga njesite e qeverisjes se pergjithshme”

Bashkengjitur, ju lutem gjeni Udhezimin e Ministrit te Financave *Nr.50, date 9.12.2009*, “Mbi krijimin dhe perdorimin e fondit te vecante nga njesite e qeverisjes se pergjithshme”.

Duke ju falenderuar per bashkepunimin,

**Alfred PRIFTI**

\_\_\_\_\_  
**Sekretar i Pergjithshem**